



Në bazë të nenit 10.1 pika b), nenin 13.1 pika a) të Ligjit për Tokën Bujqësore, nr.02/L-26, nenit 6 pika 6.3 dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nr.41/2006, nenit 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 të Statutit të Komunës së Klinës, 01nr. 01-110-1232/2010, të dt.31.03.2010, nenin 5 të Ligjit për Rrugët nr. 2003/11, si dhe propozimin e Kryetarit të Komunës të dt.18.03.2015 dhe së fundmi duke ju referua edhe përgjegjës së Ministrisë së Infrastrukturës nr. prot. 3606 si dhe pëlqimit të DUMM nr.prot.3606 i dt.05.08.2015, Kuvendi i Komunës në seancën e vet të rregullt të IV-me radhe të mbajtur me datën 29/04/2016, mori këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET**, ndërrimi i destinimit të tokës Pronë Shoqërore-rrugët e cila shfrytëzohet si tokë bujqësore aktualisht kullosë tani në tokë ndërtimore dhe atë parcela kadastrale **P-71011065-00100-2** e cila është e evidentuar në emër prone shoqërore Rrugët, sipas certifikatës pronësore nr.10-8918 të dt.14.10.2015 ZK Deiq Komuna e Klinës, me sipërfaqe prej 2115m² (21 ari e 15 metra) me kulture kullosë e klasit të pestë vendi i quajtur livadhet e thata.
- II. Ndërrimi i destinimit të tokës në pronësi shoqërore-rrugë është i përhershëm dhe bëhet pa pagesën e ndërrimit të destinimit të tokës nga ajo e tretmanit-rrugë, me të cilën administron komuna tani në tokë ndërtimore.
- III. Ndërrimi i destinimit bëhet me qëllim të harmonizimit të gjendjes faktike në terren me gjendjen kadastrale, për formim të parcelës në mënyrë që të krijohen kushtet për shfrytëzim racional të saj.
- IV. Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë, që të bëjë ndryshimet përkatëse kadastrale në librat kadastrale në bazë të vendimit përkatës, ashtu që në vend të tretmanit *tokë bujqësore* të evidentohet tretmani *tokë ndërtimore* në emër të Komunës së Klinës.
- V. Pjese përbërëse të këtij Vendimi janë: Propozimi i Kryetarit të Komunës, nr.01-464-2101/2015 i dt.18.03.2015, përgjigja e Ministrisë së Infrastrukturës, nr.prot.3605, certifikata e pronës, nr.10-8918.

- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Klinë.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me rastin e konfirmimit të ligjshmërisë së tij nga MAPL-ja, përkatësisht 15 ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
- VIII. Me Vendim të njoftohen: MAPL-ja, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronësisë, Kryetari, si dhe Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS-KLINË

01Nr. 06-2357 2016
Klinë, më 29.04.2016

